



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 03.10.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Ismet Beqiri, Daut Haradinaj, Bahrim Shabani, Aida Dërguti, Xhelal Sveçla dhe Fadil Beka, anëtarë.

**Mungoi:** Ramiz Kelmendi.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.09.2018;
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
6. Të ndryshme.

*Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.09.2018**

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes**

**Kryetari** i njoftoi se nga Qeveria e Kosovës është proceduar pakoja e projektligjeve për FSK-në. Gjithashtu propozoi që duke qenë se janë projektligje të një institucioni të votohen në pako.

**Ismet Beqiri** theksoi se ardhja e këtyre projektligjeve është e një rëndësie të veçantë duke deklaruar edhe votën e tij, e cila është për kalimin tyre. Po ashtu theksoi se shpreson që janë bërë konsultime me faktorët relevant dhe si të tilla këto projektligje të procedohen në Kuvend.

**Fatmir Xhelili**, sa i përket mënyrës së votimit, propozoi që të bëhet votimi një nga një për projektligjet. Ndërsa sa i përket këtij procesi theksoi se është një proces i transformimit të FSK-së dhe do të marrë kohë ndoshta një proces dhjetëvjeçar, duke shtuar që bashkë me faktorin ndërkombëtar do të bashkëpunohet, pasi qëllimi është që të krijohet një forcë në koordinim me faktorin ndërkombëtar, ku si forcë do të jetë pjesëmarrëse që t'i kontribuojë sigurisë. Po ashtu e konsideroi si pozitive ndihmën e NATO-s, KFOR-it dhe segmentet e tjerë të sigurisë, do të jetë një modus më i madh që zhvillimi i forcës të bëhet për qëllime paqësore. Po ashtu theksoi se vota e tij dhe e grupit parlamentar që i përket të PDK-së është për këto projektligje.

**Ismet Beqiri**, për shkak të një obligimi, theksoi se e deponon votën e tij për këto projektligje.

**Rexhep Selimi**, për projektligjet në rend të ditës, shprehu votën për, pra votën e tij dhe të grupit parlamentar të Vetëvendosjes. Po ashtu theksoi se pritjet kanë qenë më të mëdha, se ndryshimi i misionit të FSK-së të bëhet me ndryshime kushtetues, por pavarësisht kësaj e mbështesin procesin.

**Zoran Mojsilović**, duke iu referuar rendit të ditës që ka të bëjë me projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nga emërtimet duket që vetëm emri ka mbetur i njëjtë, ndërsa në brendi ligjet kanë ndryshuar dhe në kuptim të plotë është transformimi i FSK-së në ushtri. Tutje theksoi se e dinë që këto projektligje janë në kundërshtim më ato rekomandime që kanë marrë si deputetë me vizitën e realizuar në NATO gjatë këtij viti, pasi e vetmja prezencë ushtarake e pranueshme është KFOR-i. Po ashtu theksoi se Lista Serbe nuk i përkrah këto projektligje.

**Aida Dërguti** theksoi se duke qenë që arritja e transformimit përmes ndryshimeve kushtetuese është një mundësi e humbur për shkak të inateve partiake, kjo është mundësia e dytë që të bëhet një avancim i misionit të FSK-së. Po ashtu theksoi se dihet tashmë që Lista Serbe nuk do të votojë. Po ashtu theksoi e të gjitha shtet që e kanë njohur Kosovës si shtet, nuk e kanë kushtëzuar Kosovën që të mos bëjë ushtri. Në parim e përkrah këtë projektligj, por edhe grupi parlamentar i PSD-së.

**Fatmir Xhelili**, duke iu referuar performancës së FSK-së, e cila ka qenë e gatshme për të afuar mbështetje qytetarëve serbë, pasi FSK u ka dalë në ndihëm në situata emergjente ose në rastet e fatkeqësive natyrore. Po ashtu theksoi se FSK është forcë multietnike e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pasi fakti që ka prezent në FSK pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, kjo tregon që kanë besim në të, duke shpresuar që në muajt në vijim të ketë qytetarë të komunitetit jo shumicë që t'i bashkohen FSK-së, përfshirë edhe ata që kanë dhënë dorëheqje.

**Daut Haradinaj**, duke iu referuar projektligjeve për FSK-në, theksoi që më e mira do të ishte sikur të bëhen me ndryshime kushtetues, por aktualisht ky është hapi që mund të merret më tutje dhe e konsideroi të arritur këtë gjë.

**Bahrim Shabani** i përshëndeti të pranishmit dhe shtoi se e përkrah procedimin e këtyre projektligjeve, po ashtu është edhe qëndrim i grupit parlamentar 6+ edhe në komisione edhe në seancë plenare.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër( Zoran Mojsiloviq) nxori këtë:*

#### **REKOAMNDIM**

*Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes , vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.*

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër( Zoran Mojsiloviq) nxori këtë:*

#### **REKOAMNDIM**

*Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit, nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së*

*Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.*

**5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës**

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër( Zoran Mojsilović) nxori këtë:*

***REKOAMNDIM***

*Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit, nr.06/L-12 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.*

**6. Të ndryshme.**

Nuk pati çështje për të diskutuar.

**Kryetari,** me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**